

🏠 Location: Uranija Ohrid
📅 Date: 30 June - 7 July 2019
🕒 Time: 10-18

Thirrje për pjesëmarrje në
SHKOLLA E OHRIT E SË DREJTËS NATYRORE
me temë:
„Sfidat e reformave në sistemin juridik, politik dhe të sigurisë“

30 qershor – 7 korrik 2019
Qendra për shkencë dhe art „Urania“, Ohër

Qendra për hulumtime strategjike „Ksente Bogoev“ e ASHAM, me përkrahje nga Ambasada e SHBA në Shkup, e organizon sesionin e pestë të **Shkollës së Ohrit të së drejtës natyrore**, me temë: *Sfidat e reformave në sistemin juridik, politik dhe të sigurisë*, në periudhën prej 30 qershor – 7 korrik 2019.

Në kuadër të Shkollës së Ohrit parashihet aftësim shkencor dhe përsosje për **20 studentë** të studimeve pasdiplomike (cikli i dytë i studimeve) dhe **5 studentë** të studimeve të doktoraturës (cikli i tretë i studimeve) në fushën e shkencave të drejtësisë, ekonomisë dhe shkencave politike në kuadër të universiteteve shtetërore dhe private në shtetin tonë. Për gjuhë komunikimi në punimet e shkollës parashihen gjuha maqedonase dhe gjuha angleze. Secila ditë pune ka një njësi tematike të veçantë, që paraqet mundësi të jashtëzakonshme për thellimin dhe mësimin kritik të proceseve reformuese që presin vendin tonë.

U bëjmë thirrje studentëve të ciklit të dytë dhe të tretë të studimeve, të drejtësisë, shkencave politike dhe ekonomisë, të paraqiten në këtë thirrje dhe të marrin pjesë në Shkollën e Ohrit për të drejtën natyrore.

Studentët duhet të jenë të regjistruar në ciklin e dytë apo të tretë të studimeve për (drejtësi, ekonomi, shkencat politike) dhe ta njohin gjuhën angleze. Studentët duhet të kenë mundësi që ta ndjekin këtë shkollë në kohëzgjatjen e saj të plotë.

Studentët e interesuar mund të paraqiten me dorëzimin e **formularit të plotësuar** (në vazhdim të thirrjes) në këtë adresë elektronike: prirodnopravo@manu.edu.mk përfshirë edhe **letrën motivuese** me çka do ta shprehin interesim për temën dhe motivacionin personal.

Afati i paraqitjes është deri më 31 maj 2019.

 Location: Uranija Ohrid Date: 30 June - 7 July 2019 Time: 10-18

Të gjitha shpenzimet për akomodim, ushqim dhe materiale punuese janë të mbuluara nga organizatori.

Nga
Anëtarët e Këshillit organizues

 Location: Uranija Ohrid
 Date: 30 June - 7 July 2019
 Time: 10-18

1. Emri dhe mbiemri:

2. Universiteti dhe fakulteti i studimeve:

3. Drejtimi i studimeve dhe semestri:

4. Moshë:

5. Vendbanimi:

6. Suksesi i juaj mesatar në studimet deridiplomike:

7. A keni mundësi të merrni pjesë gjatë tërë kohës sa zgjat Shkolla?

Po / Jo

8. Pritshmëritë nga Shkolla:

9. Propozimet dhe idetë tuaja për Shkollën e Ohrit për të drejtën natyrore:



E-maili



Telefoni



🏠 Location: Uranija Ohrid
📅 Date: 30 June - 7 July 2019
🕒 Time: 10-18

Letër motivuese e shkurtë

(jo më tepër se 400 fjalë)

